



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
SHOQËRIA PËRMBARIMORE GJYQËSORE PRIVATE
“VAKO & PARTNERS BAILIFF SERVICE” Sh.p.k

Adresa: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Kulla nr. 5, Nr. 55, Tiranë Tel. 00355 42 427667

Nr. 979 Prot

Tiranë më 17.06.2014

Nr. 296 Dosje

URDHËR

PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE

Drejtuar : QENDRËS KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT (QKR – TIRANË)

Unë, Altin Vako, me detyrën e përmbaruesit gjyqësor, pranë Shoqërisë së Përmbarimit Privat “Vako & Partners Bailiff Service”, në referim të Urdhërit të Ekzekutimit Nr. 449 Regj.Them, të lëshuar më datë 25.04.2014 nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, kam vënë në ekzekutim këtë urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr. 296, datë 03.06.2014 kërkesën e kreditorit Inspektoriat Ndërtimor Urbanistik Kombëtar (INUK) ndaj debitorit Z. Viktor Mile, në lidhje me titullin ekzekutiv, “Vendim për Dënimin me Gjobjë” Nr. 20, datë 22.01.2013.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshem, duke i dërguar debitorit lajmërimin Nr. 912 Prot, datë 03.06.2014 për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban urdhëri i ekzekutimit Nr. 449, Regj.Them, të lëshuar më datë 25.04.2014, në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

KONSTATOJ

Se debitori, Z. Viktor Mile ka marrë njoftimin e Lajmërimin për Ekzekutimin Vullnetar të Detyrimit dhe nuk i është pergjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të këtij lajmërimi.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi sendet e luajtëshme apo të paluajtëshme të debitorit Z. Viktor Mile, në masen që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Për sa më sipër, në referim të neneve 31 pika (b), 32 pikat (c) dhe 46 (paragrafi i I-re) të Ligjit Nr.10031, datë 11.12.2008 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”,



URDHËROJ

1. Vendosjen e masës së sekuestros konservative mbi të gjitha aksionet e zotëruara nga:
 - a) Debitori: me Emër Tregtar - "VIKTOR MILE", regjistruar në Qendren Kombetare të Regjistrimit, si "Person Fizik", me Nr. NIPT-i: K64501401H.
 - b) Debitori: Z. Viktor Mile, (atesia: Miter. Datëlindja: 26.08.1968)
2. Pas vënies së masës së sekuestros, të informohemi në lidhje me:
 - a) adresën e ushtrimit të veprimtarisë private.
 - b) llojin e aktivitetit për të cilin është pajisur me licencë.
 - c) bllokimin e shitjes së aksioneve dhe tjetërsimit të aktivitetit.
3. Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brënda afatit ligjor.
4. Personat që bëhen pengesë, do të përgjigjen në bazë të nenit 606 të K.Pr.Civile (parag.II) që parashikon vendosjen e sanksionit të gjobës dhe kallzimin penal.
5. Kundër detyrimit që përcakton ky urdhër, i cili është një veprim procedural përmbarimor i referuar në K.Pr.Civile, pala debitore mundet të paraqesë ankim para Gjykatës Së Rrethit Gjyqësor, 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes njoftim të këtij urdhëri
6. Ky urdhër përpilohet dhe mbahet në disa kopje.

SHOQËRIA PËRMBARIMORE GJYQËSORE PRIVATE

"VAKO & PARTNERS BAILIFF SERVICE" Sh.p.k

PËRMBARUES GJYQËSOR

ALTIN VAKO

